



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Arsimit Kultures, Sportit Rinise, Trashigimise Kulturore, Dhenies se Titujve
dhe Emertimeve

Nr 2559/1 Prot



Fushë-Arrëz, më 26.08.2025

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 24, datë 08/08/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me Projekt vendimin **“Për miratimin e Planit të Arsimit Parauniversitar 2025-2028 në Bashkinë Fushë-Arrëz”**

Analiza ligjore Është në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 69/2018 “Për Sistemin e Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 9936/ 2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligji Nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", Ligji Nr. 9632/ 2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar dhe sipas relacionit të hartuar nga Sektori i Arsim, Kulturë, Rini, Sporte,

Situata aktuale e funksionit: Plani ofron një analizë të detajuar për të gjithë Bashkinë Fushë-Arrëz në lidhje me arsimin parauniversitar. Në total, në këtë bashki funksionojnë 9 kopshte publike, 3 shkolla 9-vjeçare publike 1 shkolle e mesme publike. Gjithsej në vitin 2025 bashkia menaxhon 111 punonjës që i takojnë sistemit parauniversitar të arsimit, nga këto 107 edukativ dhe 4 punonjës ndihmës. Në raport me fëmijët e lindur 3-6 vjeç në Bashkinë Fushe - Arrez fëmijët që frekuentojnë arsimin parashkollor janë rreth 75% e fëmijëve të kësaj moshe, dhe fëmijë që ende mbeten jashtë sistemit janë rreth 25%. Këto të dhëna theksojnë rëndësinë e ndërhyrjeve të fokusuara në zgjerimin e aksesit, rritjen ndërgjegjësimit komunitar dhe përmirësimin e infrastrukturës së arsimit parashkollor, me qëllim garantimin e të drejtës për arsim të barabartë dhe gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët e moshës 3-6 vjeç në territorin e Bashkisë Fushe - Arrez. Bashkia menaxhon 24 godina arsimore nga te cilat 16 prej tyre kanë nevojë për rikonstruksion ose

zgjerim për shkak të infrastrukturës së amortizuar. Gjithashtu vlen të theksohet se përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës arsimore ka luajtur rol dhe në shtimin e shkollave qendra komunitare që tani në Bashkinë Fushe - Arrez janë 3 shkolla nga të cilat 29 - vjeçare dhe 1 shkolle e mesme.

Plani Vendor për Arsimin Parauniversitar në Bashkinë Fushe-Arrez është ndërtuar në përputhje të plotë me prioritetet e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026, duke siguruar që objektivat dhe masat e ndërmarra në nivel lokal të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe të integruar të arsimit në nivel kombëtar. Plani do të ketë një rol shumë të rëndësishëm për Bashkinë Fushe-arrez dhe ai synon të përmirësojë në mënyrë të ndjeshme të gjitha proceset që lidhen me Arsimin Parauniversitar. Konkretisht nëpërmjet planit synohet të realizohet: Zgjerimi i rrjetit të kopshteve për të përfshirë më shumë fëmijë në arsimin parashkollor. Masa për parandalimin e braktisjes shkollore në zonat periferike dhe komunitetet vulnerabël. Trajnime të vazhdueshme për mësuesit në metodologji bashkëkohore dhe përdorim teknologjisë. të Pajisja e shkollave me laboratorë, mjete didaktike moderne dhe lidhje të qëndrueshme me internet. Parashikimi i fondeve në buxhetin vendor për programe trajnuese dhe certifikime të stafit mësuesor e ndihmës. Krijimi i rrjeteve të bashkëpunimit midis institucioneve arsimore për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira. e Kjo përputhje i jep Planit Vendor një qasje të integruar dhe garanton që çdo ndërhyrje në territorin Bashkisë Fushe-Arrez është pjesë e një vizioni më të gjerë kombëtar për një sistem arsimor më të fortë, më gjithëpërfshirës dhe më cilësor.

Situata financiare Financimi i planit do të sigurohet përmes transfertave nga buxheti i shtetit dhe projekteve të bashkëpunimit janë përcaktuar nevojat buxhetore për secilën masë ndërhyrje, si dhe është hartuar një plan afatmesëm buxhetor për të mbështetur realizimin objektivave. Transferimet specifike mbulojnë zërat e mëposhtëm. Arsimin parashkollor përfshirë pagat e stafit arsimor dhe ndihmës, kostot e mirëmbajtjes dhe funksionimit infrastrukturës së kopshteve. Arsimin 9-vjeçar, Arsimin e mesëm përfshirë pagat për personelin ndihmës, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së shkollave.

Investimet Kapitale të Planifikuara e Plani i investimeve kapitale i Bashkisë Fushe - Arrez për Arsimin Parauniversitar për periudhën 2026–2028 është ndërtuar mbi objektivin e përmirësimit të infrastrukturës ekzistuese, ndërtimit të godinave të reja, pajisjes së institucioneve arsimore me orëndi dhe logjistikë moderne, si dhe garantimit të kushteve të sigurta për fëmijët dhe të rinjtë në procesin edukativ. Të gjitha projektet e planifikuara do të financohen nga buxheti vendor i bashkisë. Këto ndërhyrje përfaqësojnë një angazhim të qartë për modernizimin infrastrukturës arsimore, rritjen e aksesit dhe përmirësimin e kushteve të të nxënies, si për Sistemin parauniversitar. Zyra e Arsimit, Kultures, Rinisë dhe Sporteve në bashkinë Fushe - Arrez nëpërmjet këtij relacioni kërkon miratimin nga Komisioni i Arsimit dhe dërgimin për miratim në mbledhjen e radhës Këshillit Bashkiak Fushe-Arrez.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Arsimit dhe Kultures ka relatuar përpara komisionit për Projekt Vendimin.

Monitorimi dhe raportimi: Komisioni i Arsimit Kultures, Sportit Rinise, Trashigimise Kulturore, Dhenies se Titujve dhe Emertimeve dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtoria e Arsimit dhe Kultures për zbatimin e projektit.

Impakti social / grupet që preken: Impakton jetën të gjitha te gjithë banoret e Bashkise dhe te ardhmen e te gjithë femijeve dhe te rinjve qe jetojne ne territorin e Bashkise Fushe Arrez.

A është objekt i konsultimit publik: Eshte objekt konsultimi publik dhe konsultimi me publikun eshte mbajtur me date 25 Gusht 2025.

Komisioni i Komisioni i Arsimit Kultures, Sportit Rinise, Trashigimise Kulturore, Dhenies se Titujve dhe Emertimeve, i mbledhur me datën 26/08/2025, shqyrtoi projekt vendimin "Për miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën 2025-2028" paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,
Komisioni me shumicë votash,


VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës** i paraqitur në Relacionin e mbledhjes së Komisionit

Franc Doda  **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Tereze Dema  **Sekretar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Arsimit Kultures, Sportit Rinise, Trashigimise Kulturore, Dhenies se Titujve dhe Emertimeve

Nr 2559

Prot



Fushë-Arrëz, më 26.08.2025

PËR : KËSHILLIN E BASHKISË

FUSHË-ARRËZ

Lënda: Relacion mbi Projektvendimin për Planin Vendor të Arsimit Parauniversitar 2025-2028 për Bashkinë Fushë-Arrëz”që do t’i paraqitet Këshillit të Bashkisë për shqyrtim në mbledhjen e tij të datës 27.08.2025.

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Per vetëqerisjen vendore”, i ndryshuar; Rregullores për Funksionimin e Këshillit të Bashkisë, Komisioni i Arsimit Kultures, Sportit Rinise, Trashigimise Kulturore, Dhenies se Titujve dhe Emertimeve, në mbledhjen e datës 26.08.2025 me pjesëmarrjen e anëtareve: Franc Doda, Tereze Dema, mori në shqyrtim projektvendimin mbi Planin Vendor të Arsimit Parauniversitar 2025-2028 për Bashkinë Fushë-Arrëz”paraqitur nga Sektori i Arsimit.

Altin Engjëlli, Specialist per Arsimin ne Bashki, thote se:

Plani i Arsimit Parauniversitar 2025–2028 për Bashkinë Fushe-Arrez është një dokument strategjik i domosdoshëm që synon të orientojë zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimeve arsimore në territorin e Bashkisë për tre vitet e ardhshme. Hartimi i tij është rezultat i një analize të thelluar të situatës aktuale, tendencave demografike, nevojave komunitare dhe sfidave ekzistuese në arsimin parashkollor, bazë dhe të mesëm. Ky dokument është një instrument thelbësor planifikimi për strukturat vendimmarrëse dhe administrative për të garantuar një arsimim cilësor dhe gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë në Bashkinë Fushe - Arrez.

Plani ofron një analizë të detajuar për të gjithë Bashkine Fushë-Arrëz në lidhje me arsimin parauniversitar. Në total, në këtë bashki funksionojnë 9 kopshte publike, 3 shkolla 9-vjeçare publike , 1 shkolle e mesme publike. Gjithsej në vitin 2025 bashkia menaxhon 111 punonjës që i takojnë sistemit parauniversitar të arsimit, nga këto 107 edukativ dhe 4 punonjës ndihmës. Në raport me fëmijët e lindur 3-6 vjeç në Bashkinë Fushe - Arrez fëmijët që frekuentojnë arsimin parashkollor janë rreth 75% e fëmijëve të kësaj moshe, dhe fëmijë që ende mbeten jashtë sistemit janë rreth 25%. Këto të dhëna theksojnë rëndësinë e ndërhyrjeve të fokusuara në zgjerimin e aksesit, rritjen e ndërgjegjësimit komunitar dhe përmirësimin e infrastrukturës së arsimit parashkollor, me qëllim garantimin e të drejtës për arsim të barabartë dhe gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët e moshës 3–6 vjeç në territorin e Bashkisë Fushe - Arrez. Bashkia menaxhon 24 godina arsimore nga te cilat 16 prej tyre kanë nevojë për rikonstrukcion ose zgjerim për shkak të infrastrukturës së amortizuar. Gjithashtu vlen të theksohet se përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës arsimore ka luajtur rol dhe në shtimin e shkollave qendra komunitare që tani në Bashkinë Fushe - Arrez janë 3 shkolla nga të cilat 2 9 - vjeçare dhe 1 shkolle e mesme.

Vizioni i planit është të garantojmë një sistem arsimor të barabartë, gjithëpërfshirës dhe cilësor për çdo fëmijë dhe të ri në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz

Objektivat strategjike përfshijnë:

- Rritja e aksesit në arsimin parauniversitar për të gjithë fëmijët e Bashkisë Fushe-arrez, me fokus në zonat më të pafavorizuara dhe grupet vulnerabël.
- Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe përdorimi i metodave bashkëkohore në procesin e mësimdhënies
- Forcimi i kapaciteteve të mësuesve dhe drejtuesve të shkollave për të siguruar një menaxhim efikas dhe inovativ.
- Mbështetjen për fëmijët me aftësi ndryshe dhe nga grupe të marginalizuara,
- Forcimin e rolit të shkollës si qendër komunitare.

Plani Vendor për Arsimin Parauniversitar në Bashkinë Fushe-Arrez është ndërtuar në përputhje të plotë me prioritetet e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026, duke siguruar që objektivat dhe masat e ndërmarra në nivel lokal të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe të integruar të arsimit në nivel kombëtar. Plani do të ketë një rol shumë të rëndësishëm për Bashkinë Fushe-arrez dhe ai synon të përmirësojë në mënyrë të ndjeshme të gjitha proceset që lidhen me Arsimin Parauniversitar.

Konkretisht nëpërmjet planit synohet të realizohet :

- Zgjerimi i rrjetit të kopshteve për të përfshirë më shumë fëmijë në arsimin parashkollor.
- Masa për parandalimin e braktisjes shkollore në zonat periferike dhe komunitetet vulnerabël.
- Trajnime të vazhdueshme për mësuesit në metodologji bashkëkohore dhe përdorim të teknologjisë.
- Pajisja e shkollave me laboratorë, mjete didaktike moderne dhe lidhje të qëndrueshme me internet.
- Parashikimi i fondeve në buxhetin vendor për programe trajnuese dhe certifikime të stafit mësimor e ndihmës.
- Krijimi i rrjeteve të bashkëpunimit midis institucioneve arsimore për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira.

Kjo përputhje i jep Planit Vendor një qasje të integruar dhe garanton që çdo ndërhyrje në territorin e Bashkisë Fushe-Arrez është pjesë e një vizioni më të gjerë kombëtar për një sistem arsimor më të fortë, më gjithëpërfshirës dhe më cilësor.

Plani i investimeve kapitale i Bashkisë Fushe - Arrez për Arsimin Parauniversitar për periudhën 2026–2028 është ndërtuar mbi objektivin e përmirësimit të infrastrukturës ekzistuese, ndërtimit të godinave të reja, pajisjes së institucioneve arsimore me orëndi dhe logjistikë moderne, si dhe garantimit të kushteve të sigurta për fëmijët dhe të rinjtë në procesin edukativ. Të gjitha projektet e planifikuara do të financohen nga buxheti vendor i bashkisë.

Pa asnjë diskutim, anëtarët e komisionit me shumicë votash, ranë dakort me projektin e paraqitur duke e dërguar atë për miratim në mbledhjen e datës 27.08.2025 të Këshillit Bashkiak, duke kërkuar edhe mendime dhe propozime të tjera të këshilltarëve të pranishëm.

PER KOMISIONIN

Franc Doda

